

VENDIM
Nr. 31, datë 4.2.2021

MBI FILLIMIN E PROCEDURËS PËR LICENCIMIN E SHOQËRISË “ARIS ALBANIA” SHPK NË VEPRIMTARINË E PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE NGA HEC “GURI I ZI”, ME KAPACITET TË INSTALUAR 1719 kw, HEC “DAZNJANË” ME KAPACITET TË INSTALUAR 1518 kw, DHE HEC “SHËLLI” ME KAPACITET TË INSTALUAR 1518 kw, ME KAPACITET TOTAL TË INSTALUAR 4755 kw

Në mbështetje të nenit 16 dhe të nenit 37, pika 2, germa “a”, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; të nenit 4, pika 1, germa “a”, të nenit 5, pika 1, germa “a”, të nenit 10, pika 3 dhe të nenit 11, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s, nr. 109, datë 29.6.2016, të ndryshuar, si dhe të nenit 19, pika 1, germa “a”, të “Rregullores së organizimit, funksionimit dhe procedurave të ERE-s”, të miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016, Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 4.2.2021, mbasi shqyrtoi relacionin nr. 20/7 prot., datë 1.2.2021, të Drejtorisë së Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes mbi aplikimin e shoqërisë “Aris Albania” sh.p.k. për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike,

konstatoi se:

- Shoqëria “Aris Albania” sh.p.k., me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 109 prot., datë 25.1.2021, ka paraqitur kërkesën për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike, nga HEC “Daznjanë” me kapacitet të instaluar 1518 kw, me vendndodhje në përroin e Daznjanës, i cili derdhet në lumin e Kurvajtit, ky i fundit me derdhje në liqenin artificial të Ulzës, Bashkia Mat, qarku Dibër; HEC “Guri i Zi” me kapacitet të instaluar 1719 kw, me vendndodhje në pjesën e sipërme të lumit Kurvajt dhe në degët e tij, Bashkia Mat, qarku Dibër, dhe HEC “Shëlli” me kapacitet të instaluar 1518 kw, me vendndodhje në përroin e grykës së Shëllit, i cili derdhet në lumin Kurvajt, ky i fundit me derdhje në Liqenin artificial të Ulzës, Bashkia Mat, qarku Dibër.

- Shoqëria ka kryer pagesën e aplikimit për t’u pajisur me licencë prodhimi nga ERE, në zbatim të aneksit A, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”.

- Nga analiza e dokumentacionit, në fazën e fillimit të procedurave të licencimit në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike, për shoqërinë “Aris Albania” sh.p.k., rezulton se subjekti plotëson kryesisht kërkesat e “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, si më poshtë:

- formati dhe dokumentacioni për aplikim, neni 9, pika 1, gjerat: “a”, “b” dhe “c”, pa plotësuar;
- dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor, neni 9, pika 2, gjerat: “a”, “b”, “c”, “e”, “f”, “g”, plotësuar;
- dokumentacioni financiar dhe fiskal, neni 9, pika 3, gjerat: “a”, “b”, “d”, plotësuar;
- dokumentacioni teknik për HEC, neni 9, pikat: 4.1.2; 4.1.3, gjerat: “a”, “b”, “c”, “d”, dhe pika 4.1.4, gjerat: “a”, “b”, “c”, “e”, “f”, plotësuar;
- leje nga institucione të tjera, neni 9, pika 4.1.5, gjerat: “a”, “c”, plotësuar.
- Në lidhje me dokumentacionin e plotësuar pjesërisht apo të pa plotësuar që ka të bëjë me:
- formatin dhe dokumentacionin për aplikim, neni 9, pika 1, germa “a” (të dhënat për aplikim), germa “b” (të dhëna identifikuese për aplikuesit) dhe germa “c” (të dhëna për aplikuesin);

- dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor, neni 9, pika 2, germa “d” (vërtetim që shoqëria dhe drejtuesit kryesorë të saj, në rastin e personave juridikë, nuk janë të përfshirë në një proces penal të filluar nga organet e drejtësisë (vërtetim nga prokuroria dhe gjykata e qarkut të Dibrës për administratorin e saj, duke qenë se shoqëria nuk ka seli në Tiranë);

- dokumentacioni teknik për HEC, neni 9, pika 4.1.1, të dhëna teknike për HEC “Guri i Zi”, “Daznjanë” dhe “Shëlli” (plotësimi i “Ekonomisë pyjore” dhe “Datës së fillimit të operimit për të tri HEC”);

- lejet nga institucionet e tjera, neni 9, pika 4.1.5, germa b. Leja e shfrytëzimit të ujit për prodhimin e energjisë elektrike për HEC “Shëlli”, do të njoftohet subjekti, që në bazë të nenit 11, pika 1, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënie, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, t’i paraqesë ato brenda afateve.

- Në përfundim të afatit të lejeve të shfrytëzimit të burimit ujqor (data e përfundimit 27.4.2022), me nr. 99 prot., datë 8.5.2017, për HEC “Daznjanë” dhe nr. 100 prot., datë 8.5.2017, për HEC “Guri i Zi”, do t’i kërkohet shoqërisë që t’i paraqesë në ERE me afate të rinovuara, jo më vonë se 1 muaj nga nënshkrimi i rinovimit.

- Në përfundim të afatit të kontratës së qirasë me Bashkinë Gramsh (data e përfundimit 16.7.2021), do t’i kërkohet shoqërisë ta depozitojë atë me afate të rinovuara, jo më vonë se një muaj pas nënshkrimit të rinovimit.

- Kontrata me nr. 2638 rep., nr. 1242/3 kol., datë 24.11.2017, “Për ndërtimin, shfrytëzimin dhe administrimin e hidrocentralit ‘Guri i Zi’, me kapacitet prodhues 1719 kw, në pjesën e sipërme të lumit të Kurvajt dhe në degët e tij, Bashkia Mat, qarku Dibër”; kontrata me nr. 2639 rep., nr.1243 kol., datë 24.11.2017, “Për ndërtimin, shfrytëzimin dhe administrimin e hidrocentralit ‘Daznjanë’, me kapacitet prodhues 1518 kw, në përroin e Daznjanës, i cili derdhet në lumin e Kurvajtit, ky i fundit me derdhje në liqenin artificial të Ulzëz, Bashkia Mat, qarku Dibër”; kontrata me nr. 2440 rep., nr. 1244/3 kol., datë 24.11.2017, “Për ndërtimin, shfrytëzimin dhe administrimin e hidrocentralit ‘Shëlli’, me kapacitet prodhues 1518 kw në përroin e grykës së Shëllit, i cili derdhet në lumin e Kurvajtit, ky i fundit me derdhje në liqenin artificial të Ulzëz, Bashkia Mat, qarku Dibër”, të lidhura midis MIE-s dhe mbajtësit të miratimit shoqërisë “Aris Albania” sh.p.k., kanë një afat 49-vjeçar, por nga ana tjetër shpjegojmë se ERE, në zbatim të nenit 38, të ligjit “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, dhe të nenit 5, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, nuk mund të japë për veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike një licencë me afat më të madh se 30 vjet.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të fillojë procedurën për licencimin e shoqërisë “Aris Albania” sh.p.k. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC “Guri i Zi” me kapacitet të instaluar 1719 kw, HEC “Daznjanë” me kapacitet të instaluar 1518 kw, dhe HEC “Shëlli” me kapacitet të instaluar 1518 kw, me kapacitet total të instaluar 4755 kw, për një afat 30-vjeçar.

2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Për këtë vendim mund të kërkohet rishikim në ERE brenda 7 ditëve kalendarike, si dhe mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti